REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**RADIO TELEVIZIONI SHQIPTAR**

# NJOFTIM

Radio Televizioni Shqiptar njofton të gjithë të interesuarit, aplikues për vendin e lirë të punës, të plotësojnë dhe depozitojnë dokumentacionin si më poshtë:

1. Formularin e aplikimit për punësim (kliko këtu)
2. Formularin e vetëdeklarimit (FORMULAR VETËDEKLARIMI )
3. Jetëshkrim në gjuhën shqipe;
4. Fotokopje e kartës së identitetit(ID);
5. Referenca.

**Dokumentacioni duhet të depozitohet pranë zyrës së Protokollit të RTSH-së ose aplikimit elektronik në adresën info@rtsh.al deri më 13 Tetor 2026.**

**Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatëve.**

1 vend pune në pozicionin:

**"Redaktor/Përkthyes (spanjisht/anglisht)" në Sektorin e Përkthimit në Njësinë e Programeve**

Kandidatët që aplikojnë për pozicionin "Redaktor/Përkthyes (spanjisht/anglisht)" në Sektorin e Përkthimit, në Njësinë e Programeve të plotësojnë kërkesat e përgjithshme si dhe kërkesat e veçanta të vendit të punës si më poshtë:

**1.Kërkesat e përgjithshme të vendit të punës:**

1.1 Të jetë shtetas shqiptar;
1.2 Të mos jenë të dënuar me vendim gjykate të formës së prerë.

**2. Kërkesat e veçanta të vendit të punës:**

2.1 Të ketë arsimin e lartë.
2.2 Të ketë standart të lartë të gjuhës shqipe në të shkruar dhe në të folur.
2.3 Të jetë njohës i mirë i gjuhës spanjolle dhe angleze.
2.4 Të ketë njohje të shkëlqyera të paketës Office.
2.5 Të ketë eksperiencë në redaktim/përkthim simultan, subritim.
2.6 Të ketë aftësi në caktimin e prioriteteve dhe për të punuar në mënyrë efikase nën presion.
2.7 Të ketë aftësi për të bashkëpunuar me maturi në grup.